

ARTA MALSHI

GJUHA DHE GJINIA

1. Një vështrim historik mbi gjuhën dhe gjininë

Marrëdhënia midis gjuhës dhe gjinisë ka shfaqur interes brenda sociolinguistikës dhe disiplinave të tjera. Njerëzit e dinin me kohë që gjinia dhe përdorimi i gjuhës lidhen bashkë. Studimet e hershme të shekullit XX, vëzhguan ndryshimet midis të folurit të burrave dhe grave nëpër disa gjuhë, duke identifikuar forma të gjuhës të burrave dhe grave. Pra, studime të hershme antropologjike në gjuhën e sekseve të fokusuar në kulturat jo-perëndimore, raportuan se burrat dhe gratë flisnin gjuhë të ndryshme, megjithatë këto raportime u zbuluan kohët e fundi si shumë të ekzagjeruara.

Gjinia ka qenë gjithmonë një variabël social në studimet sasiore të variacionit gjuhësor të zbatuara që në vitet 1960. Një zbulim i fundit atë kohë, ishte që midis folësve nga e njëjta shtresë shoqërore, gratë synonin të përdornin më tepër tiparet e standardit dhe gjuhën e prestigjit dhe burrat më tepër tipare të gjuhës vernakulare. Aspektet e interpretimit dhe të metodologjisë së përshtatur për studimet e variacionit janë kritikuar nga disa studiues të gjuhës dhe gjinisë.¹

Si një fushë e nxitur nga lulëzimi i lëvizjes së grave perëndimore, gjuha dhe gjinia u themelua në 1970 me shumë interes, veçanërisht nga studiuesit, për mbizotërimin e burrave në bisedat me të dy gjinitë e përziera p.sh. burrat që ndërpresin gratë më shpesh sesa anasjelltas, në identifikimin e stileve të të folurit të burrave dhe grave, si p.sh. një zbulim i zakonshëm është se gratë synojnë të përdorin stilet e të folurit mbështetës dhe bashkëpunues, ndërsa burrat më tepër stilet konkurruese. Fusha është, gjithashtu, e karakterizuar nga pozicione të ndryshme me termat “deficit”, “dominimi i burrave” dhe “ndryshimi kulturor.”

Kërkimi që lidhet me pozicionin e deficitit, e shikoi përdorimin e gjuhës së grave si të mangët në lidhje me gjuhën e burrave në mënyra të ndryshme; pozicioni i mbizotërimit të burrave vuri shumë theksin në ndryshimin në fuqinë midis folësve burra dhe gra, ndërsa pozicioni i ndryshimit kulturor e shikoi përdorimin e gjuhës së burrave dhe grave si të ndryshëm nga ana kulturore, por jo të pabarabartë. Gjuha e grave dhe burrave është interpretuar, gjithashtu, në marrëdhënie me teorinë e mirësjelljes: gratë shikohen më të sjellshme nga ana gjuhësore sesa burrat.²

Kohët e fundit dhe veçanërisht në studimet e bëra që në fillimet e viteve 1990, gjinia është rikonceptuar në një zgjerim të rëndësishëm, e ndikuar nga teoritë

¹ Shih: *Sociolinguistic Variation* Cameron, 1992; Coates, 1986/2004; Graddol and Swann, 1989.

² Holmes (1995) *Women, Men and Politeness*, New York, Longman and Mills (2003). *Gender and politeness*; Cambridge University Press.

bashkëkohore, që kanë lidhje me poststrukturalizmin. Gjinia është parë më pak rregullator dhe fenomen bashkues gjer më sot me studime që theksojnë ose të paktën njohin diversitetin e konsiderueshëm midis folësve meshkuj dhe femra; marrëdhënia e ndryshme midis gjinisë dhe aspekteve të tjera të identitetit dhe rëndësia e kontekstit në përcaktimin se si e përdorin njerëzit gjuhën. Nga kjo pikëpamje, gjinia është konsideruar si më pak atributi primar që ndikon në përdorimin e gjuhës dhe më tepër si një arritje bashkëvepruese, diçka që mund të performohet në mënyra specifike në kontekste të ndryshme. Veçanërisht, vëzhgime të brendshme interesante në një fenomen të tillë kanë ardhur nga studimet e fundit të gjuhës dhe gjinisë. Studimi ka eksploruar biseda të lidhura me feminitetin apo mashkullorësinë. Ka pasur diskutime të vlefshme për çështjet metodologjike, si p.sh. metoda të ndryshme mund të sjellin gjëra të reja në studimin e gjuhës dhe gjinisë, duke përfshirë sociolinguistikën e varianteve, etnografinë gjuhësore, analizat e bisedës, analizat kritike të ligjëratës, psikologjinë e bisedës dhe analizat e bisedës poststrukturaliste feministe.³

Brenda gjinisë dhe gjuhës si një fushë, theksi ka rënë mbi gjuhën dhe gjininë, si fenomene sociale dhe në ndërtimin social të gjinisë dhe të identitetit në praktikat gjuhësore dhe të tjera. Ka pasur diskutime të kufizuara në problemet njohëse, siç janë ndryshimet në aftësinë verbale dhe në shpjegimet biologjike për sjelljen njerëzore, duke përfshirë sjelljen gjuhësore. Megjithatë, një përmbledhje e fushës⁴ sugjeron që studiuesit e gjuhës dhe gjinisë duhet të angazhohen me seriozitet dhe në mënyrë kritike me sfidat e parashtruara nga shpjegimet biologjike.⁵

Gjuha e ndarë nga gjinia në shoqëritë industriale nuk u mor si një temë serioze studimi deri në vitet 1960 dhe nuk shpërtheu si një nëndegë në të drejtën e saj, deri në publikimin e librit të Robin Lakov “*Gjuha dhe Vendi i Grave*” në 1975. Ai përshkroi stilin e të folurit tipik femëror të karakterizuar nga përdorimi i tipareve të tilla, si: përcaktorë, pyetjet e shkurtra, mbiemrat dhe karakteristikat e tjera, të cilat, sipas gruas, kishin një funksion të caktuar: të dobësojnë forcën e thënies. Kështu, pyetjet e shkurtra janë të lidhura me dëshirën për konfirmim dhe aprovim.

2. Gjuha dhe gjinia

Variacioni sipas gjinisë së folësit, ka qenë tema e mjaft kërkimeve të fundit. Është zbuluar që burrat përdorin urdhra më të drejtpërdrejta sesa femrat. Një fenomen sintaksor, ka tërhequr vëmendjen e Lakovit⁶, që gratë përdorin pyetje të

³ D. Cameron (1998), *The Feminist Critique of Language*. London: Routledge.

⁴ D. Cameron (2005), *Language, gender and sexuality: current issues and new directions*, Applied Linguistics.

⁵ S. Baron-Cohen (2003), *The Essential Difference: men, women and the extreme male brain*. London: Allen Lane.

⁶ R. Lakoff, *Language and Woman's Place*, 1975, Përshkrimi i Lakovit për stilin e të folurit të femrave u bazua në përshtypjet e saj sesa në ndonjë vëshim kuantitativ. P.sh., disa studime tregonin që burrat përdornin pyetje të shkurtra. Por ishin gratë që i përdornin ato për të konfirmuar dhe tregonin mungesë të vetbesimit.

shkurtra për të kërkuar aprovimin apo konfirmimin e opinionit personal, ndërsa përdorimi i pyetjeve të shkurtra për burrat është kryesisht për të parandaluar kundërshtimin, p.sh. *Apo jo?* Një përfundim i përgjithshëm nga studimet e dialektit është se femrat synojnë të përdorin forma më me prestigj se sa burrat me të njëjtën shtresë shoqërore dhe arsimim. Burrat flasin më tepër gjuhë informale, p.sh. në anglisht ne dëgjojmë burra që thonë: “*I done it*” (e bëra), “*He ain’t tough*” (ai nuk është i ashpër) (*ain’t* –formë informale e formës formale *isn’t*, që do të thotë nuk është). Ndërsa femrat përdorin format formale: “*I did it*” (e bëra). “*He isn’t tough*”. (ai nuk është i ashpër).

Gjuha ndryshon në shumë mënyra. Gjinia e folësit është një nga tiparet që kohët e fundit ka pasur shumë interes.

Dallimi gjinor i gjuhës është rezultati i një gjuhe mashkullore dhe ky përdorim është rrënjësor në stereotipet e zbatuara nga përdoruesit e gjuhës, p.sh. gratë janë më të shoqërueshme, të brishta, entuziaste, të lirshme, ndërsa burrat janë mjaft të fortë, dominues, flasin me zë të lartë dhe dalin direkt në temën që ata synojnë. Në studimin e tij, Nilsen raportoi 385 hyrje të reja në fjalor, të cilat janë krejt mashkullore dhe 132 të cilat janë femërore. Stereotipi vazhdon më tej, duke i vendosur gratë, përgjithësisht, në kontekste shtëpiake dhe situata emocionale, ndërsa burrat janë të lidhur me investimet e biznesit.

3. Gjuha që përdoret nga burrat dhe gratë

Duke vijuar, jam përpjekur të paraqes një listë për gjuhën që përdoret nga burrat dhe gratë. Në listë, futen shtresat gjuhësore si leksiku (tema e bisedës, zhargoni), gramatika (pyetjet e shkurtra, fjalitë urdhërore, modalitetin, gjatësia e fjalisë, gramatika jo-standarde dhe shqiptimi (cilësia e zërit, intonacioni dhe shqiptimi i varianteve fonologjike).

3.1 Fjalori

Ka pasur relativisht pak diskutime në fushën e zgjedhjes së fjalorit, aq i gjerë sa është. Por në fakt, disa zona kanë qenë objekt i vëzhgimit dhe studimit, si: tema e diskutimit, gjuha e mirësjelljes, emocionale dhe mbështetëse, ngjyrat, konceptet e hapësirës, fjalët tabu dhe fjalitë çuditëse.

Tema: Zbulimet e vlefshme, për sa i përket temave të bisedës dhe fushave të fjalorit, tregojnë që gratë duket sikur shmangin tema të caktuara, si paratë, biznesi, politika, ndërsa ata përqendrohen më tepër tek njerëzit, veshjet dhe dekoracionet. Burrat favorizojnë tema, siç janë paratë, biznesi, politika, sporti. Kjo është e kuptueshme, sepse në mënyrë tradicionale ka pasur mjaft angazhime të burrave në punësime, politikë dhe sport, ndërsa gratë janë të orientuara më tepër në situata shtëpiake. Është bërë shumë, veçanërisht nga feministët për një gjuhë dhe sjellje mbështetëse të grave, e kundërshtuar me sjelljen dominuese dhe konkurruese të burrave.

Termet për ngjyrat, hapësirën dhe gjuha tabu: Një nga tezat kryesore të ngritura për sa i përket fjalorit specifik të gjinisë, është që ka tipare që mendohet të jenë tipike për përdorimin e femrave, si p.sh. termat për ngjyrat: bizele për gratë, ndërsa për burrat jeshile e hapur, ose bezhë për gratë, ndërsa nga burrat përdorin kafe e hapur. Për më tepër, gratë përdorin shprehje theksuese si shumë, mjaft të

tilla, gjerë, tmerrësisht shumë dhe mbiemrat: e adhureshme, mahnitëse, e ëmbël, e këndshme, hyjnore. Disa studime kanë treguar që burrat duket se kanë një tendencë më të fortë për të përdorur terma të hapësirës dhe që ata janë më të orientuar drejt paraqitjeve të fakteve, ndërsa gratë janë më të shprehura. Për fjalitë çuditëse apo mënyra habitore, forma tipike e burrave është më me tepër forcë dhe jo e rafinuar si tek shprehjet tipike femërore. Lakov sugjeroi që “Oh zot” (Oh dear) është femërore dhe “Dreq” (shi...) është mashkullore.

Zhargoni: Burrat, përgjithësisht, përdorin më tepër zhargon ose gjuhën e përditshme sesa gratë. Përdorimi i madh i zhargonit tek burrat, është interpretuar në si një tregues i solidaritetit midis burrave.

3.2 Gramatika

Në fushën e gramatikës, nuk ka divergjenca kryesore midis burrave dhe grave, që flasin anglisht. **Fjalitë urdhërore:** Burrat, për shembull, mund të përdorin mënyrën urdhërore dhe forma të tjera të urdhërores në mënyrë më të drejtpërdrejtë sesa femrat. Në një investigim të gjuhës së përdorur nga dy fëmijë pesëvjeçarë në një situatë loje (në rolin e doktorit), u zbulua që vajzat kishin një tendencë t’i zbusnin urdhrat e tyre dhe një pjesë e urdhrave, kërkesave dhe komandave të djemve, ishin urdhra të drejtpërdrejta (Sille atë në spital) dhe një pjesë e tyre ishin ndalime (mos e prek atë). Në anën tjetër, vajzat përdornin urdhra të përbashkëta (Tani ne duhet ta mbulojmë atë.). Studimet kanë treguar se qëndrimi i fëmijëve është kryesisht një imitim i roleve të prindërve të tyre.

Pyetjet e shkurtra: Një fenomen i mëtejshëm sintaksor, i cili kishte tërhequr vëmendjen e Lakovit, ishte që gratë përdorin shumë më tepër pyetje të shkurtra, që kërkojnë aprovimin apo konfirmimin e një opinion personal, p.sh. *Mënyra si janë rritur çmimet është e habitshme, apo jo?* Në një përpjekje për të verifikuar këtë, u numëruan pyetjet e shkurtra të përdorura në një konferencë akademike dhe u vu re që shumica ishin përdorur nga burrat. Por këto pyetje ishin “larg nga të treguarit mungesë besimi” por kishin qëllim të parandalonin kundërshtimin.

Gramatika jostandarde: Duket se ka një lidhje midis gjuhës jostandarde dhe burrave, p.sh. *Asnjë s’po shkon ndokund në asnjë mënyrë. (Ain’t nobody going nowhere noway).* Në standard, kemi një mohim.

Modaliteti: Shpesh i referohet gjuhësore ndihmëse. Gratë i përdorin me tepër këto mjete, sesa burrat. Gratë përdorin, gjithashtu, më tepër forma të mirësjelljes, që do të thotë më shumë modalitet, p.sh. *Po mendoja sikur ju të më bënit një nder, nëse nuk e keni problem.*

Gjatësia e fjalisë: Ka pak prova që vajzat përdorin fjali më të gjata se djemtë, por kjo mund të jetë e kundërta në moshë madhore. Gratë përdorin, gjithashtu, citime direkte, sesa parafrazojnë.

Frekuenca e mbiemrave: Vajzat përdorin mbiemra më shumë se djemtë, si në të folurit, ashtu edhe në shkrim. Gratë përdorin më tepër mbiemra vlerësues. Kjo duket te stereotipi i përhapur i grave që funksionon sipas ndjenjave dhe emocioneve, sesa nga logjika dhe arsyetimi. Gratë përdorin më shumë se burrat ndajfoljet: afërsisht, rreth dhe përforcues, si: shumë, gjerë, tmerrësisht shumë etj.

3.3 Shqiptimi

Cilësia i zërit: Djemtë e ri flasin sikur të ishin më të mëdhenj, ndërsa vajzat e reja flasin sikur të ishin më të vogla. Kjo ndodh sipas konfiguracionit në distancë midis bandave të frekuencës së tingullit, e prodhuar kur artikulohej zanoret. Zëri si pëshpëritje është femëror, ndërsa zëri grykor është pozitiv për burrat, sepse i tregon më të pjekur, realistë dhe të sofistikuar, por për gratë është negative, se i tregon më pak inteligjente, dembele dhe më tepër mashkullore.

Intonacioni: Gratë përdorin intonacionin e ngritur dhe kjo tregon një shkallë të lartë të pasigurisë dhe një shkallë të madhe të rezervimit dhe të mirësjelljes. Toni i zërit të grave është më dinamik se sa i burrave.

4. Ndryshimet midis të folurit të burrave dhe grave

Burrat dhe gratë tentojnë, në përgjithësi, të përdorin stile të ndryshme të gjuhës. Këto ndryshime mund të jenë kuantitive (sasiore), sesa kualitative (cilësore). Pra, kjo do të thotë që gratë japin përgjigje të shkurtra, minimale, ndërsa burrat shprehen më gjatë në përgjigje. Identifikimi fillestar i regjistrimit të grave u bë nga Robin Lakoff⁷ i cili tregoi që stili i gjuhës shërben për të mbajtur rolin inferior të grave në shoqëri (metoda e deficitit femëror). Një diskutim i mëvonshëm i këtij argumenti, ishte që ndryshimet e gjinisë në gjuhë reflektonin një ndryshim në fuqi (teoria e dominancës).

Kohët e fundit janë krahasuar ndryshimet e gjinisë në gjuhë, si të njëjta me ndryshimet kulturore (metoda e ndryshimit kulturor).

5. Strategjitë e komunikimit

Në këtë ndarje, pyetja qendrore përfshin mënyrën se si folësit përdorin gjuhën për të komunikuar. Kjo përmban zgjedhjen e temave dhe tipat e teksteve apo zhanrit, sasinë e të folurit të prodhuar, gjatësinë e thënieve, ndërprerjet e bisedës dhe mjete të tjera për të përcaktuar për çfarë po bisedojmë dhe çështjen e mirësjelljes.

Temat dhe llojet e teksteve. Burrat bëjnë më tepër vërejtje të mprehta dhe të zgjuara, p.sh. në një takim në një spital të të sëmurëve mendorë, burrat e marrin seriozisht dhe thonë shprehje të zgjuara, ndërsa gratë shpesh qeshin shumë.

Sjellja mbizotëruese:

a) **5.1. Sasia e të folurit:** Ka një stereotip femëror llafazan dhe thashathemaxhi.

A- Cilat janë tre mjetet më të shpejta të komunikimit?

- Telegrafi, telefoni dhe tregoi një gruaje

Megjithatë, duket se janë burrat që flasin më shumë, duke marrë parasysh numrin e kundërpërgjigjeve dhe gjatësinë mesatare të tyre. Gjatësia e kundërpërgjigjeve të burrave është më e gjatë sesa e grave.

b) **5.2. Kontrolli i temës: Ndërprerja e bisedës.** Ndoshta mënyra më e drejtpërdrejtë e të përcaktuarit kush do të flasë dhe çfarë teme bisede, do të jetë gjatë ndërprerjes, e cila është një mjet për të ushtruar fuqinë dhe kontrollin në bisedë. Në shumë investigime të bisedave që përfshijnë çifte në vende publike,

⁷ R. Lakoff, *Language and Woman's Place*, 1975.

tregojnë që të gjitha ndërprerjet dhe bllokimet në bisedë janë bërë nga folësit meshkuj. Ndërprerja nga gratë mund të frenohet nga faktorë të tillë: shkelja e së drejtës për të folur nga burrat, dëshira e burrave për të treguar mbizotërim. Është zbuluar që gratë duhet të përsërisin pyetjen tre herë më shumë se burrat. Pra, burrat i ndërpresin gratë dhe jo anasjelltas në biseda kur janë të përfshira të dyja gjinitë.

Ndryshimi i temës së bisedës. Burrat tentojnë të ndryshojnë temën më shpesh se sa femrat. Ky ndryshim mund të jetë për shkak të konceptimit që gratë dërdëllisin dhe flasin shumë.

Zgjedhja e temës. Burrat mund të refuzojnë zgjedhjen e temave nga gratë në bisedat midis dy gjinive të përziera, ndërsa gratë bisedojnë në tema të caktuara nga burrat.

c) 5.3. Përgjigjet minimale. Gratë prodhojnë përgjigje më tepër sesa burrat, si p.sh. *mmm, uhuhu, dhe jeah*, të cilat tregojnë dëgjimin aktiv dhe nxisin folësin për të vazhduar. Dukshëm gratë janë më të gatshme të luajnë role bashkëbiseduese mbështetëse. Gratë përdorin *mmm, hmm*, në mënyrë më të rëndësishme se sa burrat, veçanërisht në bisedat grua me grua. Zhurma të tilla së bashku me njësi gjuhësore të tilla si “ëhë” dhe “po shoh” funksionojnë si sinjale, në mënyrë që kanali i komunikimit të mbetet i hapur. Burrat, përgjithësisht, i përdorin më pak dhe kur i përdorin zakonisht për të treguar aprovim ose se janë dakord për diçka.

Mirësjellja. Mund të flasim për lloje të ndryshme të mirësjelljes. Gratë praktikojnë mirësjellje pozitive, duke rritur interesin e tyre tek dëgjuesi nëpërmjet përdorimit të pyetjeve të shkurtra, fjalët që tregojnë identitetin e grupit etj. Burrat shfaqin modele të mirësjelljes negative, që do të thotë se atë kërkojnë të minimizojnë imponimin. Ata janë të drejtuar për detyrën, të japin opinione, të japin informacion, duke kundërshtuar. Ata janë të interesuar në mbajtjen e reputacionit. Gratë, në anën tjetër, duan të respektohen dhe ata shfaqin sjellje social-emocionale, dramatizim dhe tregojnë tension. Mirësjellja është përshkruar në aspektin pozitiv dhe negativ. Aspekti pozitiv i referohet dëshirës se dikujt për t’u pëlqyer dhe admiruar, ndërsa aspekti negativ i referohet dëshirës së dikujt për të qenë i pavarur. Të dyja format janë përdorur më shpesh nga gratë.

Pyetjet. Burrat dhe gratë ndryshojnë në përdorimin e pyetjeve në bisedë. Në shkrime, të dyja gjinitë përdorin pyetjet retorike, si mjete letrare. P.sh. Mark Twain i përdori ata për të nxitur lexuesin të bëjë pyetje për veprimet dhe besimet e tij.

Zgjedhja e akteve të të folurit dhe realizimi i tyre. Burrat përdorin më shumë urdhra sesa gratë dhe përpiqen t’i realizojnë ata në përputhje me zgjedhjen e mënyrës urdhërore. Kur gratë japin urdhra, ata nuk i realizojnë në përputhje me mënyrën e duhur, por duke zgjedhur formën pyetëse, shpesh të modalizuar (*A mundeni të mbyllni derën?*) ose duke përdorur një fjali pohore, p.sh. (*Po mendoj se si mund të jesh aq i sjellshëm, sa të mbyllje derën*). Zgjedhja e këtyre formave është shpjeguar si mirësjellje, e cila shpesh mundohet të fshehë se çfarë po ndodh nga ana gjuhësore. Nocioni i realizimit të përputhshëm dhe jo i përputhshëm duket shumë i dobishëm.

Gjuha dhe gjinia

Agresioni verbal. Burrat tentojnë të jenë më agresiv verbalisht. (Labov, 1972), duke përdorur shpesh kërcënime, blasfemi, ulërime, britma dhe duke thirrur emrin. Gratë, në përgjithësi, mendojnë ta përçajnë këtë rrjedhë bisede dhe jo si një mjet për të mbajtur statusin hierarkik në bisedë. Kur gratë betohen, është për t'i demonstruar të tjerëve çfarë është sjellje normale për to.

Të dëgjuarit dhe vëmendja. Duket se gratë i kushtojnë më tepër rëndësi se burrat të dëgjuarit në bisedë. Kjo tregohet nga shkalla më e ulët e ndërprerjes, si p.s., duke përçarë rrjedhën e bisedës me një temë që nuk ka lidhje me atë përpara dhe duke rritur përdorimin e përgjigjeve minimale në krahasim me burrat. Burrat, megjithatë, ndërpresin shumë më shpesh me tema pa lidhje, veçanërisht në situata me të dyja gjinitë dhe duke pasur parasysh përgjigjet minimale të femrës.

